



# KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS

Prishtinë,  
2016



## Përmbajtja

Fjala hyrëse.....	3
Vizioni .....	4
Misioni .....	4
Vlerat .....	4
1.Kush është Këshilli Prokurorial i Kosovës? .....	5
2.Mandati i Këshillit .....	5
3.Përbërja e Këshillit.....	6
4.Si zgjedhën anëtarët e Këshillit? .....	6
5.Mandati i anëtarëve të Këshillit.....	
Si merren vendimet e Këshillit? .....	8
6.Kush e udhëheq Këshillin?.....	9
6.1. Trupat funksional të Këshillit.....	10
7. Mbështetja administrative e Këshillit.....	11
7.1. Sekretariati i Këshillit .....	11
7.2. Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë .....	12
8.Transparenca dhe qasja në punën e Këshillit.....	12
9.Mekanizmat e krijuar që i shërbejnë transparencës në punën e Këshillit.....	13
10.Aktet kryesore juridike që e rregullojnë veprimtarinë e Këshillit.....	13
11.Si mund ta kontaktojmë Këshillin Prokurorial të Kosovës? .....	14

***Publikuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës © KPK 2016,***

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK).

### Fjala hyrëse

Jam i nderuar të prezantoj broshurën për Këshillin Prokurorial të Kosovës e cila ka për qëllim të ofroj informacione mbi rolin dhe funksionimin e këtij institucioni në kuadër të sistemit prokurorial.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, si institucion kushtetues dhe i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij angazhohet në fuqizimin e kapaciteteve profesionale dhe infrastrukturore të sistemit prokurorial me qëllim të ofrimit të një sistemi efikas, efektiv dhe të drejtë të hetimit dhe ndjekjes penale.

Duke besuar fuqishëm se qasja në drejtësi është e drejtë e wqytetarëve dhe jo një mundësi ne jemi të përkushtuar që brenda Këshillit të zhvillojmë sa më shumë mekanizma që e mundësojnë këtë qasje. Në këtë drejtim, krahas mbajtjes së takimeve në prani të mediave, përditësimit të faqes zyrtare me vendime dhe aktivitete të Këshillit, caktimin e zyrtarëve për komunikim me publikun, jemi të angazhuar edhe në publikime të ndryshme që ofrojnë informacion për punën tonë, siç është edhe kjo broshurë.

Broshura krahas informacionit për mandatin dhe punën ofron edhe adresat e kontaktit të Këshillit Prokurorial të Kosovës e që lehtëson komunikimin me publikun për çka është edhe synim i imi.

Ju faleminderit!



**Blerim Isufaj,**

**Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës**

### **Vizioni**

Vizioni ynë është puna e vazhdueshme për arritjen e standardeve dhe vlerave më të larta të ndershmerisë, integritetit, profesionalizmit dhe transparencës në sistemin prokurorial të Kosovës përmes bërjes së politikave dhe marrjes së vendimeve të cilat sigurojnë pavarësinë, paanshmërinë dhe efikasitetin e tij.

### **Misioni**

Misioni ynë është sigurimi i një sistemi efikas dhe efektiv të hetimit dhe ndjekjes penale nga prokurorë të rekrutuar në bazë të meritës, të vlerësuar në bazë të rezultateve në punë dhe të mbikëqyrur sipas standardeve të larta si dhe ofrimi i resurseve adekuate humane dhe infrastrukturore.

### **Vlerat**

Këshilli Prokurorial i Kosovës mbështetet në këto vlera:

- Ne jemi institucion kushtetues;
- Ne realizojmë mandatin tonë të pavarur dhe pa ndërhyrje nga pushtetet tjera;
- Kemi përfaqësim gjithëpërfshirës dhe vlerësojmë diversitetin;
- Kemi kapacitete funksionale për zhvillim të politikave dhe strategjive;
- Jemi transparent në vendimmarrje;
- Ne promovojmë qasjen e barabartë në shërbimet tona për të gjithë.



### 1. Kush është Këshilli Prokurorial i Kosovës?

Këshilli Prokurorial i Kosovës (më tutje Këshilli) është institucion i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional dhe i paanshëm e që pasqyron natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës përfshirë dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht të barazisë gjinore. Ky mandat është i përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (2008).

Deri në nxjerrjen Kushtetutës së Republikës së Kosovës (2008) mandati lidhur me menaxhimin e sistemit prokurorial, të cilin sot e ushtron Këshilli, është ushtruar nga një organ i përbashkët i njohur si Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës.

Krijimi i bazës kushtetuese dhe nxjerrja e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës që ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2011 mundësuan themelimin e Këshillit si institucion i pavarur në menaxhimin me sistemin prokurorial të Kosovës.

Në këtë mandat Këshilli ka pasur 9 anëtarë. Mbledhja e parë e Këshillit është mbajtur me 7 shkurt 2011.

### 2. Mandati i Këshillit

Mandati i Këshillit buron nga Kushtetuta dhe ligji që e përcakton atë si një institucion plotësisht të pavarur në ushtrimin e funksioneve prokuroriale.

Këshilli menaxhon buxhetin vjetor për Këshillin dhe prokuroritë në mënyrë të pavarur dhe mban përgjegjësi për mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimin e fondeve, mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale dhe auditimeve financiare.



Përgjegjësitë tjera të Këshillit janë si në vijim:

- Siguron që prokurorët të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kr yerjes së të gjitha funksioneve prokuroriale;
- Rekruton dhe propozon te Presidenti kandidatët për emërim dhe riemërim për prokurorë dhe Kryeprokurorin e Shtetit;
- Vlerëson, ngrit në detyrë, disiplinon, shkarkon, transferon dhe ofron mbështetje për trajnimin e prokurorëve.
- Në bashkëpunim në Institutin Gjyqësor të Kosovës, themelon standardet për rekrutimin, organizimin dhe shpalljen e provimit përgatitor për kualifikimin e prokurorëve;
- Në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit zhvillon politikat dhe strategjitë prokuroriale për luftimin efektiv të kriminalitetit;
- Bën përgatitjen dhe mbikëqyrjen e buxhetit të sistemit prokurorial.



### 3. Përbërja e Këshillit

Nga 1 janari i vitit 2016, sipas ndryshim plotësimit të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshilli përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, dhjetë (10) prej tyre prokurorë, tre jo prokurorë.

Këshilli përbëhet nga:

- Kryeprokurori i Shtetit sipas detyrës zyrtare (ex officio);
- Shtatë (7) anëtarë prokurorë, një (1) nga çdo prokurori Themelore;
- Një (1) anëtar prokuror nga Prokuroria e Apelit;
- Një (1) anëtar prokuror nga Prokuroria Speciale;
- Një (1) anëtar Avokat nga Oda e Avokatëve të Kosovës;
- Një (1) anëtar, Profesor Universitar i fakulteteve juridike dhe
- Një (1) anëtar, përfaqësues nga Shoqëria Civile.

Këshilli sigurohet që përbërja e tij të reflektojë natyrën shumë etnike dhe barazinë gjinore duke përcaktuar që së paku një anëtar të jetë nga radhët e komuniteteve jo shumicë dhe së paku tre (3) anëtarë të jenë nga gjinia femërore.

### 4. Si zgjedhën anëtarët e Këshillit?

Zgjedhja dhe emërimi i anëtarëve të Këshillit bazohet në performancën e lartë profesionale, reputacionin moral dhe integritetin personal të tyre, duke siguruar një proces të zgjedhjes të mbështetur në parimet e konkurrencës, transparencës, paanshmërisë, objektivitetit, barazisë gjinore dhe shumë – etnicitetit.

Këshilli shpall zgjedhjet për anëtarët prokurorë, së paku tre (3) muaj para përfundimit të mandatit të anëtarëve ekzistues.

Anëtarët prokurorë të Këshillit zgjedhën me votim të fshehtë nga prokurorët e prokurorive përkatëse. Kandidatët duhet të mos jenë dënuar me vepër penale dhe të mos kenë ndonjë masë të shqiptuar disiplinore në tri vitet e fundit.

Tre (3) anëtarët jo prokuror të Këshillit zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Oda e Avokatëve të Kosovës dhe fakultetet juridike i nominojnë së paku tre (3) kandidatëve, ndërsa për përfaqësuesin e shoqërisë civile, Këshilli shpall konkurs publik ku duhet të aplikojnë së paku tre persona. Nominimet nga OAK dhe fakulteteve juridike se bashku me kandidatët nga shoqëria civile dërgohen për emërim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

### **5. Mandati i anëtarëve të Këshillit**

Mandati i anëtarëve të Këshillit është pesë (5) vjeçar.

Kryeprokurori i Shtetit si anëtar i Këshillit ka mandat sipas detyrës zyrtare (*ex officio*).

Anëtarëve të Këshillit u pushon mandati me:

- Vdekje;
- Humbjen e zotësisë për veprim për më shumë se tre (3) muaj për shkak të arsyeve mjekësore të vërtetuara;
- Dështimin e vazhdueshëm për të marrë pjesë në veprimtaritë e Këshillit për më shumë se tre (3) muaj;
- Pushimin e statusit mbi të cilin bazohet emërimi, nëse emërimi bazohet në një status të caktuar;
- Skadimin e mandatit;
- Dorëheqje duke informuar Këshillin me njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh.

## Këshilli Prokurorial i Kosovës / 2016

Anëtarët prokurorë të Këshillit shkarkohen nga funksioni me 2/3 e votave të anëtarëve të Këshillit dhe në pajtim me Rregulloren e Këshillit, ndërsa anëtarët jo prokuror të cilët zgjidhen nga Kuvendi, shkarkohen me propozim të Këshillit me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit nëse:

- Funksionin e anëtarit të Këshillit nuk e kryen në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin;
- Ushtrojnë funksionin në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre;
- Dënohen për vepër penale.





## 6. Si merren vendimet e Këshillit?

Vendimet e Këshillit merren me shumicë të thjeshtë të votave nga anëtarët e pranishëm, përveç nëse ligji e përcakton ndryshe.

Për të marrë vendim, Këshillit i duhet kuorumi cili arrihet nëse në takim marrin pjesë nëntë (9) anëtarë me të drejtë vote.

Anëtarët e Këshillit i ushtrojnë detyrat e tyre zyrtare në mënyrë të pavarur dhe të paanshme dhe nuk mbajnë përgjegjësi penale për vendimet, mendimet dhe veprimet, brenda fushëveprimit të tyre si anëtar të Këshillit.

## 7. Kush e udhëheq Këshillin?

Këshilli udhëhiqet nga Kryesuesi i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve prokurorë të Këshillit, me mandat tre (3) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.

Sipas mandatit që ka, Kryesuesi i Këshillit:

- Kryeson të gjitha takimet e Këshillit;
- Përfaqëson Këshillin para publikut, agjencive qeveritare dhe organeve të tjera publike vendore dhe ndërkombëtare;
- Mbikëqyr dhe menaxhon punën e Këshillit dhe komisioneve të tij.

Kryesuesi i Këshillit së paku një herë në vit paraqet raporte publike vjetore për performancën, veprimet, kostot dhe nevojat buxhetore të sistemit prokurorial si dhe organizon procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të komisioneve të përhershme sipas këtij ligji, duke i mundësuar Këshillit një proces transparent dhe të përgjegjshëm të propozimeve dhe emërimit të tyre.

Kryesuesin e zëvendëson njeri nga anëtarët e Këshillit i zgjedhur si Zëvendës-kryesues me procedurë të njëjtë si Kryesuesi i Këshillit. Zëvendës-kryesuesi ushtron përgjegjësitë dhe detyrat e Kryesuesit, kur ai mungon dhe ka autoritet të plotë për të vepruar në emër të Këshillit në rast të mungesës apo paaftësisë së Kryesuesit.

### 7.1. *Trupat funksional të Këshillit*

Në përmbushje të mandatit të tij, Këshilli ka në funksion trupa të ndryshme të themeluara në formë të komisioneve të përhershme dhe të përkohshme.

Komisionet e përhershme të Këshillit ndihmojnë atë në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të parapara me kushtetute dhe ligj

## Këshilli Prokurorial i Kosovës / 2016

Komisionet e përhershme zgjedhën nga Këshilli, ndërsa mandati i tyre përcaktohet me Ligj dhe akte tjera nënligjore.



Komisionet e përhershme janë:

- Komisioni për Çështje Normative;
- Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel;
- Komisioni për Administrimin e Prokurorive;
- Komisioni Disiplinor;
- Komisioni për vlerësim të performancës së prokurorëve.

Këshilli mund të themelojë edhe komisione të tjera të përkohshme ose të përhershme, sipas nevojës.

### 8. Mbështetja administrative e Këshillit

Këshilli, mbështetur në aktet ligjore, me qëllim të funksionimit më të mirë dhe efikasitetit në punë, merr mbështetje administrative nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe nga Njësi të Shtetit për Shtetimin e Performancës së Prokurorisë.

#### 8.1. Sekretariati i Këshillit

Sekretariati ofron mbështetje administrative për Këshillin, komisionet e Këshillit, trupat tjerë të Këshillit, në përmbushjen e mandatit ligjor të Prokurorit të Shtetit.

Ndër kompetencat kryesore të Sekretariatit janë:

- Ndihmon për të zbatuar rregulloret dhe politikat e Këshillit, lidhur me menaxhimin, buxhetin dhe administrimin e prokurorisë;
- Propozon rregulla administrative që janë të nevojshme për zbatimin e urdhëresave të Këshillit;
- Përgatitë dhe administron buxhetin e konsoliduar për Prokurorin e Shtetit Menaxhon me personelin administrativ dhe mbështetës të prokurorisë;
- Raporton rregullisht para Këshillit për punën administrative të prokurorisë dhe ofron rekomandime për përmirësime.



Bazuar në kompetencat e tij dhe me qëllim të mbështetjes administrative për sistemin prokurorial, Sekretariati ka adoptuar strukturën administrative e cila menaxhon me resurset njerëzore, buxhetin dhe financat, prokurimin, mbështetjen logjistike, teknologjinë informative, komunikimin me publikun dhe auditimin e brendshëm.

Sekretariati i Këshillit udhëhiqet nga Drejtori i cili është zyrtari më i lartë administrativ i Këshillit Prokurorial të Kosovës që emërohet dhe shkarkohet po nga Këshilli.

Drejtori është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas dhe efektiv të Sekretariatit dhe të prokurorive.

Drejtori i raporton drejtpërsëdrejti Kryesuesit të Këshillit. Po ashtu, merr pjesë në të gjitha takimet e Këshillit dhe i përgjigjet të gjitha kërkesave të Këshillit për informacion.

### ***8.2. Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë***

Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë raporton për punën e prokurorive.

Ndër përgjegjësitë kryesore të Njësitit janë:

- I propozon Këshillit udhëzime për reformimin dhe përmirësimin e punës së prokurorëve;
- Mbledh dhe analizon të dhënat statistikore dhe informatat lidhur me efikasitetin e punës së prokurorive;
- Përgatit raporte periodike dhe vjetore si dhe analiza për punën e prokurorive;
- Koordinon dhe mbëkëqyrë procesin e zhvillimit profesional të prokurorëve dhe personelit;
- Mbështet procesin e rekrutimit, emërimit dhe ri-emërimit të prokurorëve, përfshirë vlerësimin e performancës së tyre;

Njësi udhëhiqet nga Drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli dhe është përgjegjës për administrimin efikas dhe efektiv të Njësitit.



### 9. Transparenca dhe qasja në punën e Këshillit

Puna e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës bazohet në respektimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve, konventave ndërkombëtare dhe akteve nënligjore.

Këshilli vazhdimisht angazhohet që të përmirësojë besimin e publikut në sistemin prokurorial dhe të rrisë ndërgjegjësimin publik për nivelin në të cilën sistemi prokurorial promovon qasjen e publikut në shërbimet e drejtësisë.

Në këtë drejtim, Këshilli do të sigurojë që shërbimi i prokurorisë do t'i ofron publikut informacion të përshtatshëm në lidhje me ndjekjen penale të rasteve individuale dhe punën e shërbimit të prokurorisë përmes aktiviteteve në terren, mediave dhe aktiviteteve të tjera.

Përpyekja e Këshillit për komunikim dhe transparencë në sistemin prokurorial, në të njëjtën kohë do të respekton dhe mbron nevojën për intimitet në lidhje me hetimet, jetën private, shëndetin dhe mirëqenien e dëshmitarëve, viktimave, të pandehurve, prokurorëve dhe personave të tjerë të përfshirë sipas ligjeve për mbrojtjen e privatësisë në Kosovë.

Këshilli dhe Prokurori i Shtetit mbrojnë sigurinë e të gjitha të dhënave personale për të cilat ka përgjegjësi.



## **10. Mekanizmat e krijuar që i shërbejnë transparencës në punën e Këshillit**

Sistemi prokurorial ka të krijuar mekanizmat të cilët shërbejnë që puna dhe aktivitetet e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit të jenë sa më transparente në raport me publikun në përgjithësi, me mediat, shoqërinë civile dhe grupet tjera të interesit.

Mekanizmat e krijuar për t'i shërbyer transparencës në punën e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës janë:

- Zyra për Komunikim me Publikun;
- Zëdhënësit;
- Zyrtari për Qasje në Dokumente Publike;
- Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ueb - faqja e Këshillit Prokurorial të Kosovës – [www.kpk-rks.org](http://www.kpk-rks.org);
- Mbledhjet e hapura për publikun të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Broshurat;
- Buletinet;
- Raportet;
- Konferencat për media;
- Komunikatat;
- Njoftimet;

## 11. Aktet kryesore juridike që e rregullojnë veprimtarinë e Këshillit

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;  
(<http://kpk-rks.org/al/legjislacionii/98/kushtetuta/98>)
- Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës;  
(<http://kpk-rks.org/al/legjislacionii/99/ligjet/99>)
- Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës;  
(<http://kpk-rks.org/al/legjislacionii/99/ligjet/99>)
- Rregulloret;  
<http://kpk-rks.org/legjislacionii/196/rregulloret-2016/196>
- Udhëzimet administrative  
<http://kpk-rks.org/legjislacionii/100/udhzimet-administrative/100>
- Vendimet  
<http://kpk-rks.org/legjislacionii/197/vendimet-2016/197>

## 12. Si mund ta kontaktojmë Këshillin Prokurorial të Kosovës?

### *Këshilli Prokurorial i Kosovës:*

**Adresa:** Rruga Luan Haradinaj, nr. 16/1, zona II, kategoria II, kati V, Prishtinë – Kosovë.

**Email:** [info.kpk@rks-psh.org](mailto:info.kpk@rks-psh.org)

**Tel:** (038) 200 17 504 (**Kryesuesi i KPK-së**),

200 18 854 (**Sekretariati**),

200 17 472 (**Njësiti**),

200 18 710 (**Zyra për Komunikim Publik**).







